




REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIC OF KOSOVO  
REPUBLIKA KOSOVO

KOMUNA E KLINËS  
MUNICIPALITY OF KLINA  
OPŠTINA KLINA



[www.komuna-kline.org](http://www.komuna-kline.org)

# POLITIKAT E PRIVATËSISË NË KOMUNËN E KLINËS



Gusht, 2025

## PËRMBAJTJA

|                                                                                                                                |    |
|--------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|----|
| Përkufizimet dhe Shprehjet e Përdorura në Politikat e Privatësisë .....                                                        | 3  |
| Parimet e Përpunimit të Dhënave Personale .....                                                                                | 4  |
| Deklaratë e Kryetarit të Komunës së Klinës mbi Hartimin e Politikave të Privatësisë dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale ..... | 5  |
| Hyrje për Politikat e Privatësisë në Komunën e Klinës .....                                                                    | 6  |
| Kush i Përpunon dhe është Përgjegjës për të Dhënat tuaja Personale .....                                                       | 7  |
| Kategoria e të Dhënave që Përpunohen .....                                                                                     | 9  |
| Qëllimi i Përdorimit të Dhënave Personale .....                                                                                | 9  |
| Baza Ligjore për Përpunim.....                                                                                                 | 10 |
| Me kë i ndajmë të Dhënat Personale të Mbledhura? .....                                                                         | 10 |
| Cilat janë të Drejtat Tuaja? .....                                                                                             | 10 |
| E drejta e Ankimimit .....                                                                                                     | 11 |
| Siguria e të Dhënave Personale .....                                                                                           | 11 |
| Përditësimi i Politikës së Privatësisë .....                                                                                   | 11 |

## PËRKUFIZIMET DHE SHPREHJET E PËRDORURA NË POLITIKAT E PRIVATËSISË

**E dhënë personale** - çdo informacion në lidhje me një person fizik të identifikuar ose të identifikueshëm ("subjekt i të dhënave"); një person fizik i identifikueshëm është ai, i cili, mund të identifikohet drejtpërdrejt ose jo drejtpërdrejt, veçanërisht duke iu referuar një identifikuesi në bazë të një emri, një numri identifikimi, të dhënave rreth vendndodhjes, një identifikues online, ose një apo më shumë faktorë specifikë për identitetin fizik, psikologjik, gjenetik, mendor, ekonomik, kulturor ose social të atij personi fizik,

**Privatësi** – respektimi i jetës private dhe familjare, pacenueshmëria e banesës dhe fshehtësia e korrespondencës së telefonisë dhe e komunikimeve të tjera, në pajtim me ligjin e zbatueshëm,

**Të dhëna personale të ndjeshme** - të dhëna personale që zbulojnë origjinën etnike ose racore, pikëpamjet politike ose filozofike, përkatësinë fetare, anëtarësimin në sindikatë ose çdo e dhënë për gjendjen shëndetësore ose jetën seksuale, çfarëdo përfshirje në ose heqje nga evidencat penale ose të kundërvajtjeve që ruhen në pajtim me ligjin,

**Përpunim** - çdo veprim ose seri veprimesh që kryhen ndaj të dhënave personale me mjete automatike ose jo, si: mbledhja, regjistrimi, organizimi, strukturimi, ruajtja, përshtatja ose ndryshimi, tërheqja, konsultimi, përdorimi, publikimi nëpërmjet transmetimit, shpërndarja ose ofrimi, njësimi ose kombinimi, kufizimi, fshirja ose asgjësimi,

**Kontrollues i të dhënave** - çdo person fizik ose juridik nga sektori publik që individualisht ose së bashku me të tjerët përcakton qëllimet dhe mënyrat e përpunimit të të dhënave personale,

**Përpunues i të dhënave** - çdo person fizik ose juridik, nga sektori publik, i cili përpunon të dhëna personale për dhe në emër të kontrolluesit të të dhënave,

**Zyrtari përgjegjës për Mbrojtjen e të Dhënave Personale** - çdo person fizik ose juridik, nga sektori publik që informon dhe këshillon kontrolluesin ose përpunuesin dhe të punësuarit, të cilët kryejnë përpunimin mbi detyrimet e tyre në pajtim me Ligjin për Mbrojtjen e të Dhënave Personale dhe aktet nënligjore për mbrojtjen e të dhënave,

**Agjencia për Informim dhe Privatësi (Agjencia)** - agjenci e pavarur, përgjegjëse për mbikëqyrjen e zbatimit të legjislacionit për qasje në dokumente publike dhe mbrojtje të të dhënave personale, me qëllim që të mbrohen të drejtat dhe liritë themelore të personave fizikë, në lidhje me përpunimin e të dhënave personale, si dhe garantimin e qasjes në dokumente publike.

## PARIMET E PËRPUNIMIT TË TË DHËNAVE PERSONALE

**1. Parimi i ligjshmërisë, drejtësisë dhe transparencës** - të dhënat personale përpunohen në mënyrë të paanshme, të ligjshme dhe transparente, pa e cenuar dinjitetin e subjekteve të të dhënave,

**2. Parimi i kufizimit të qëllimit** – të dhënat personale grumbullohen vetëm për qëllime të caktuara, të qarta dhe legjitime dhe nuk mund të përpunohen më tutje në kundërshtim me këto qëllime. Përpunimi i mëtejshëm me qëllim të arkivimit për interes publik, qëllimit të hulumtimit shkencor ose historik, ose qëllimit statistikor, nuk konsiderohet që është në mospërputhje me qëllimin fillestar,

**3. Parimi i minimizimit të të dhënave** – të dhënat personale duhet të jenë adekuate, relevante dhe nuk duhet t'i tejkalojnë qëllimet për të cilat ato janë grumbulluar ose përpunuar më tutje,

**4. Parimi i saktësisë** – të dhënat personale duhet të jenë të sakta dhe të përditësuara. Duhet të merret çdo hap i arsyeshëm për të garantuar që të dhënat personale që janë të pasakta, duke pasur parasysh qëllimin e përpunimit, të fshihen dhe të korrigjohen pa vonesë.

**5. Parimi i kufizimit të ruajtjes** – të dhënat personale mund të ruhen vetëm për atë kohë sa është e nevojshme për arritjen e qëllimit, për të cilin janë grumbulluar ose përpunuar më tutje. Me rastin e përmbyshjes së qëllimit të përpunimit, të dhënat personale asgjësohen, fshihen, shkatërrohen, bllokohen ose bëhen anonime, përveç nëse është paraparë ndryshe me Ligjin përkatës për Arkivat Shtetërore ose me ndonjë ligj tjetër përkatës.

**6. Parimi i paprekshmërisë dhe konfidencialitetit** – të dhënat personale përpunohen në atë mënyrë që garantojnë siguri të përshtatshme të tyre, duke përfshirë mbrojtjen ndaj përpunimit të paautorizuar ose të paligjshëm dhe ndaj humbjes, asgjësimit ose dëmtimit aksidental, duke përdorur masa të përshtatshme teknike dhe organizative.

**7. Parimi i llogaridhënies** – kontrolluesi duhet të jetë përgjegjës dhe në gjendje të zbatojë përputhshmërinë e të gjitha parimeve të përcaktuara me ligjin për Ligjin për Mbrojtjen e të Dhënave Personale.

## DEKLARATË E KRYETARIT TË KOMUNËS SË KLINËS MBI HARTIMIN E POLITIKAVE TË PRIVATËSISË DHE MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE

Në cilësinë e Kryetarit të Komunës së Klinës, ndjej përgjegjësi dhe përkushtim të lartë për të garantuar mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore të qytetarëve tanë, përfshirë edhe të drejtën për privatësi dhe ruajtjen e të dhënave personale. Në një kohë kur teknologjia po zhvillohet me hapa të shpejtë dhe digjitalizimi i shërbimeve publike po zgjerohet dita-ditës, mbrojtja e të dhënave personale është bërë një detyrë institucionale, ligjore dhe morale që duhet të trajtohet me seriozitet dhe transparencë të plotë.

Komuna e Klinës është e angazhuar që të hartojë dhe zbatojë politika të qarta të privatësisë, të cilat përcaktojnë mënyrën e mbledhjes, përdorimit, ruajtjes dhe ndarjes së të dhënave personale të qytetarëve, në përputhje me Ligjin për Mbrojtjen e të Dhënave Personale Nr. 06/L-082, dhe standardet më të mira ndërkombëtare apo legjislacionin evropian. Këto politika do të jenë të qasshme, të kuptueshme dhe të përditësuara, duke siguruar që çdo qytetar të jetë i informuar për të drejtat dhe garancitë që ka mbi informacionin e tij personal.

Roli i këtyre politikave është kyç në krijimin e një administrate efikase, të besueshme dhe të përgjegjshme ndaj qytetarëve. Mbrojtja e të dhënave personale nuk është vetëm një detyrim ligjor, por edhe një element i rëndësishëm i ndërtimit të besimit të qytetarëve në institucionet publike. Në këtë kuadër, Komuna e Klinës do të ndërmarrë të gjitha masat e nevojshme për të siguruar sigurinë teknike dhe organizative të sistemeve të saj, për të parandaluar çdo keqpërdorim apo qasje të paautorizuar në të dhënat personale të qytetarëve.

Po ashtu, do të angazhohemi që stafi komunal të trajnohet rregullisht për rëndësinë e mbrojtjes së privatësisë dhe zbatimin praktik të politikave përkatëse. Bashkëpunimi me Agjencinë për Informim dhe Privatësi, organizatat e shoqërisë civile dhe vetë qytetarët do të jetë i vazhdueshëm dhe i hapur për përmirësime të mëtejshme.

Në përfundim, siguroj të gjithë qytetarët se Komuna e Klinës është dhe do të mbetet e përkushtuar që mbrojtja e të dhënave personale të jetë një prioritet i lartë në çdo veprim dhe politikë institucionale. Privatësia është një e drejtë themelore dhe ruajtja e saj është përgjegjësi e përbashkët që e ndërtojmë me besim, transparencë dhe përkushtim të plotë.

Kryetari i Komunës së Klinës,  
Prof. Dr. Zenun Elezaj



## HYRJE PËR POLITIKAT E PRIVATËSISË NË KOMUNËN E KLINËS

Komuna e Klinës, në përputhje me legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale, përkatësisht Ligjin për Mbrojtjen e të Dhënave Personale dhe standardet përkatëse, ka hartuar Politikën e Privatësisë me qëllim të garantimit të të drejtave dhe lirive themelore të qytetarëve, me theks të veçantë në mbrojtjen e të dhënave personale dhe privatësisë së individit. Këto politika përcaktojnë në mënyrë të qartë të drejtat, përgjegjësitë, parimet dhe masat ndëshkuese që zbatohen në rast të trajtimit të paautorizuar të të dhënave, duke siguruar njëherësh trajtimin e ligjshëm, të drejtë dhe transparent të të dhënave të tyre personale.

Qëllimi i këtyre politikave është të sigurojnë mbrojtjen efektive të të dhënave personale të individëve, të përcaktojnë qartë të drejtat dhe përgjegjësitë e palëve të përfshira, të vendosin parime udhëzuese për përpunimin e të dhënave dhe të parashohin masa ndëshkuese në rast të shkeljeve apo përdorimit të paautorizuar. Këto politika synojnë të rrisin nivelin e ndërgjegjësimit institucional dhe qytetar lidhur me rëndësinë e privatësisë dhe mbrojtjes së informacionit personal.

Fushëveprimi i këtyre politikave përfshin të gjithë sektorët dhe shërbimet brenda Komunës së Klinës që përpunojnë të dhëna personale, përfshirë të punësuarit, bashkëpunëtorët, qytetarët, ofruesit e shërbimeve publike dhe çdo palë tjetër që ka qasje ose ndërveprim me të dhënat personale në kuadër të punës institucionale. Politikën zbatohen për të gjitha format e të dhënave, qoftë në formë fizike apo digjitale.

Sipas përkufizimit ligjor, “e dhënë personale” nënkupton çdo informacion që lidhet me një person fizik të identifikuar ose të identifikueshëm, i cili mund të identifikohet drejtpërdrejt ose tërthorazi përmes një emri, numri identifikues, vendndodhjes, identifikuesve online ose veçorive të tjera specifike për identitetin e tij fizik, psikologjik, gjenetik, mendor, ekonomik, kulturor ose shoqëror.

Përmes këtyre politikave, Komuna e Klinës angazhohet të sigurojë përpunimin ligjor, të drejtë dhe transparent të të dhënave personale të qytetarëve dhe të punonjësve të saj, duke vendosur standarde të qarta për ruajtjen e konfidencialitetit dhe sigurisë. Njëkohësisht, këto politika përcaktojnë përgjegjësitë e institucionit për mbikëqyrjen e zbatimit të ligjit, si dhe për garantimin e qasjes së drejtë në dokumentet publike, pa cenuar privatësinë e individit.

Zbatimi i këtyre politikave në Komunën e Klinës përbën një hap të rëndësishëm gjithashtu drejt forcimit të transparencës institucionale, rritjes së llogaridhënies publike dhe ndërtimit të një mjedisi të sigurt dhe të besueshëm për qytetarët. Kjo politikë e mbrojtjes së të dhënave personale është e zbatueshme nëse jeni aplikant për punë, palë kontraktuese, merrni pjesë në një trajnim të organizuar nga ne, vizitoni <https://kline.rks-gov.net/> përdorni ndonjë shërbim, paraqisni kërkesë përmes email-it; [komuna.kline@rks-gov.net](mailto:komuna.kline@rks-gov.net), apo faqes tonë të internetit.

## KUSH I PËRPUNON DHE ËSHTË PËRGJEGJËS PËR TË DHËNAT TUAJA PERSONALE?

Përpunues i të dhënave personale është çdo person fizik ose juridik, nga sektori publik, i cili përpunon të dhëna personale për dhe në emër të kontrolluesit të të dhënave.

Përpunues i të dhënave personale në Komunën e Klinës është, me adresë në më adresë në kuadër të Drejtorisë së Administratës.

1. Nëse përpunimi duhet të kryhet në emër të një kontrolluesi, i njëjti përdorë vetëm përpunues që ofrojnë garanci të mjaftueshme për të zbatuar masat e përshtatshme teknike dhe organizative në një mënyrë të tillë që përpunimi të përmbushë kërkesat e këtij ligji dhe të garantojë mbrojtjen e të drejtave të subjektit të të dhënave,

2. Përpunuesi nuk angazhon një përpunues tjetër, pa autorizimin paraprak specifik ose të përgjithshëm me shkrim të kontrolluesit. Në rastin e autorizimit të përgjithshëm me shkrim, përpunuesi informon kontrolluesin për çdo ndryshim të synuar në lidhje me shtimin ose zëvendësimin e përpunuesve të tjerë, duke i dhënë kontrolluesit mundësi për të kundërshtuar këto ndryshime.

3. Përpunimi nga një përpunues rregullohet me një kontratë që është detyruese për përpunuesin në lidhje me kontrolluesin dhe që përcakton objektin dhe kohëzgjatjen e përpunimit, natyrën dhe qëllimin e përpunimit, tipin e të dhënave personale dhe kategorive të subjekteve të të dhënave dhe detyrimet dhe të drejtat e kontrolluesit. Kjo kontratë parashikon, veçanërisht, që përpunuesi:

3.1. Përpunon të dhënat personale vetëm sipas udhëzimeve të dokumentuara nga kontrolluesi, duke përfshirë në lidhje me transferimet e të dhënave personale te një vend i jashtëm ose një organizatë ndërkombëtare, përveç kur i kërkohet ta bëjë këtë nga ndonjë ligj specifik, të cilit i nënshtrohet përpunuesi; në një rast të tillë, përpunuesi informon kontrolluesin për këtë kërkesë ligjore para përpunimit, përveç kur ligji e ndalon këtë informim për shkaqe të rëndësishme të interesit publik. Përpunuesi e informon menjëherë kontrolluesin nëse, sipas mendimit të tij, ndonjë udhëzim është në kundërshtim me ligjin;

3.2. Garanton që personat e autorizuar për të përpunuar të dhënat personale i janë nënshtruar konfidencialitetit ose janë nën detyrimin ligjor të përshtatshëm të konfidencialitetit;

3.3. Merr të gjitha masat e kërkuara sipas nenit 31 të Ligjit për Mbrojtjen e të Dhënave,

3.4. Respekton kushtet e referuara në paragrafët 2. dhe 4. të këtij neni për angazhimin e një përpunuesi tjetër;

3.5. duke marrë parasysh natyrën e përpunimit, ndihmon kontrolluesin me masa të përshtatshme teknike dhe organizative, në masën që kjo është e mundur, për përmbushjen e detyrimit të kontrolluesit për t'iu përgjigjur kërkesave për ushtrimin e të drejtave të subjektit të të dhënave;

3.6. Ndhmon kontrolluesin në sigurimin e përputhshmërisë me detyrimet në pajtim me ligjin etj.

Kontrollues i të dhënave - çdo person fizik ose juridik nga sektori publik që individualisht ose së bashku me të tjerët përcakton qëllimet dhe mënyrat e përpunimit të të dhënave personale.

Përgjegjësia e kontrolluesit;

1. Duke marrë parasysh natyrën, objektin, kontekstin dhe qëllimet e përpunimit, si dhe rreziqet me mundësi ndryshimi dhe ashpërsinë për të drejtat dhe liritë e personave fizikë, kontrolluesi zbaton masa të përshtatshme teknike dhe organizative për të garantuar gatishmërinë për të demonstruar që përpunimi të kryhet në pajtim me këtë ligj. Këto masa rishikohen dhe përditësohen sipas nevojës.

2. Nëse është proporcionale në lidhje me aktivitetet përpunuese, masat e përmendura në paragrafin 1, të Ligjit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, përfshijnë zbatimin e politikave të përshtatshme për mbrojtjen e të dhënave nga kontrolluesi.

Zyrtari përgjegjës për Mbrojtjen e të Dhënave Personale ka, të paktën, detyrat e mëposhtme:

1.1. Informon dhe këshillon kontrolluesin ose përpunuesin dhe të punësuarit, të cilët kryejnë përpunimin mbi detyrimet e tyre në pajtim me këtë ligj dhe aktet nënligjore për mbrojtjen e të dhënave;

1.2. Jep këshilla, sipas rastit, në lidhje me vlerësimin e ndikimit mbi mbrojtjen e të dhënave dhe monitoron performancën,

1.3. Bashkëpunon me Agjencinë për Informim dhe Privatësi,

1.4. Vepron si pikë kontakti për Agjencinë për çështjet në lidhje me përpunimin, duke përfshirë konsultimin paraprak, të referuar në nenin 36 të këtij ligji dhe konsultohet, sipas rastit, në lidhje me çdo çështje tjetër,

2. Zyrtari për mbrojtjen e të dhënave, në përmbushje të detyrave të tij ose të saj, merr parasysh si duhet rrezikun që shoqëron veprimet e përpunimit, duke marrë parasysh natyrën, objektin, kontekstin dhe qëllimet e përpunimit.



Zyrtari përgjegjës për Mbrojtjen e të Dhënave Personale është më adresë në kuadër të Drejtorisë së Administratës, i caktuar me vendim të kryetarit të Komunës së Klinës, të dhënat e të cilit janë të publikuara në web faqen zyrtare <https://kline.rks-gov.net/>.

**Kontrolluesi:** Komuna e Klinës

**Përpunuesit:** Drejtoritë komunale, institucionet nën juridiksionin e Komunës, palë të treta kontraktuale me autorizim të posaçëm

**Zyrtari për Mbrojtjen e të Dhënave Personale:** I caktuar me vendim të Kryetarit të Komunës, në kuadër të Drejtorisë së Administratës.

## KATEGORIA E TË DHËNAVE QË PËRPUNOHET

Në varësi të qëllimeve dhe arsyeve specifike Komuna e Klinës përpunon të gjitha ose disa nga të dhënat personale të specifikuara më poshtë, ndaras ose në kombinim midis tyre:

Të dhënat e identifikimit: emri, mbiemri, të dhënat e dokumentit të identitetit,

Të dhënat e kontaktit: adresa, email, numri i telefonit,

Të dhëna për arsimin, shëndetin, kualifikimin profesional dhe veprimtarinë e punës,

Të dhëna të tjera të kërkuara sipas ligjeve të veçanta që rregullojnë marrëdhëniet e punës ose marrëdhëniet kontraktuale,

Informacione të tjera dhe të dhëna personale të nevojshme për përmbushjen e detyrimeve statutores të Komunës së Klinës për të garantuar sigurinë në ofrimin e shërbimeve të navigacionit ajror;

Foto dhe video nga konferenca apo ngjarje.

## PËR ÇFARË QËLLIMESH I PËRDORIM TË DHËNAT TUAJA PERSONALE?

Përmbushja e detyrimeve ligjore të përcaktuara me Ligjin Nr. 06/L-082 për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, dhe standardet ndërkombëtare në fuqi të Bashkimit Evropian për mbrojtjen e të dhënave personale,

Përmbushja e urdhrave të organeve kompetente shtetërore,

Ofrimin e shërbimeve publike,

Përzgjedhja e punonjësve, duke përfshirë kryerjen e trajnimeve të specializuara dhe gjuhësore për rekrutimet te reja,

Lidhja e kontratave dhe marrëdhënieve parakontraktuale,

Garantimi i sigurisë së punonjësve, vizitorëve, si dhe infrastrukturës së ndërmarrjes, përmes sistemit të mbikëqyrjes video, sigurisë fizike, kontrollit të qasjes dhe regjistrimit të vizitorëve të jashtëm,

Sigurimi i funksionimit normal, mirëmbajtjes dhe sigurisë së faqes së internetit dhe sistemeve të informacionit dhe komunikimit të Komunës së Klinës,

Organizimi dhe realizimi i trajnimeve të specializuara nga Organizata Trajnuese në Komunën e Klinës,

Përpunimi i kërkesave sipas Ligjit NR. 06/L-081 për Qasje në Dokumente Publike,

Promovimi i aktiviteteve të komunës për mbrojtjen e të dhënave personale, duke përfshirë shpërndarjen e materialeve dhe broshurave reklamuese, postimin e fotove / videove në web faqe, Facebook, Instagram, Twitter, LinkedIn ose në media tjera.

## BAZA LIGJORE PËR PËRPUNIM

Komuna e përpunon të dhënat personale të subjekteve bazuar në përputhje me Ligjin Nr. 06/L-082 për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, dhe në pajtim me legjislacionin evropian për mbrojtjen e të dhënave personale.

Në disa raste, ne përpunojmë të dhënat personale vetëm pas pëlqimit paraprak të subjektit të të dhënave. Pëlqimi i dhënë mund të tërhiqet në çdo kohë nga subjekti.

## ME KË I NDAJMË TË DHËNAT PERSONALE TË MBLEDHURA?

Autoritetet kompetente siç janë ato të sigurisë, gjyqësore dhe mbikëqyrëse, që në bazë të një akti juridik kanë autoritetin të kërkojnë nga Komuna e Klinës të dhënat personale për subjektet e caktuara.

## CILAT JANË TË DREJTAT TUAJA?

Kur të dhënat tuaja personale përpunohen nga Komuna e Klinës, ju keni të drejtë:

Të qasjes në të dhënat tuaja dhe në çdo kohë, të kërkonti t'i korrigjoni dhe përditësoni pa vonesë nëse të dhënat tuaja janë të pasakta ose jo të plota,

Të fshirjes ('e drejta për t'u harruar) së të dhënave tuaja dhe mund të kërkonti që përpunimi të ndalohet në rrethana të caktuara,

Të kërkonti që ndonjë nga ndryshimet e mësipërme t'u komunikohet palëve të tjera, të cilave u janë zbuluar të dhënat tuaja,

Të ankoheni në çdo kohë nëse besoni se të drejtat tuaja për mbrojtjen e të dhënave janë shkelur.

## E DREJTA E ANKIMIMIT

Në përputhje me Ligjin Nr. 06/L-082 për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, çdo person fizik që beson se i është shkelur e drejta për mbrojtjen e të dhënave personale, mund të paraqesë ankesë pranë Agjencisë për informim dhe Privatësi me adresë: Rr. Zejnel Salihu - Nr.22, 10000, Prishtinë, Republika e Kosovës, si dhe në emailin; [info@aip-rks.org](mailto:info@aip-rks.org).

## SIGURIA E TË DHËNAVE PERSONALE

Komuna e Klinës zbaton masat e duhura fizike, organizative dhe teknike për të mbrojtur të dhënat tuaja personale në pajtim me dispozitat përkatëse të Ligjit Nr. 06/L-082 për Mbrojtjen e të Dhënave Personale.

Kohëzgjatja e ruajtjes së të dhënave personale varet nga qëllimet e përpunimit për të cilat ato janë mbledhur dhe është e rregulluar me Ligjin përkatës për Arkivat Shtetërore ose me ndonjë ligj tjetër përkatës.

## PËRDITËSIMI I POLITIKËS SË PRIVATËSISË

Ne mund të përditësojmë herë pas here politikën tonë të privatësisë dhe do t'ju njoftojmë për çdo ndryshim duke postuar Politikën e re të Privatësisë në web faqen zyrtare të Komunës së Klinës.

Faqja e internetit mund të përmbajë linqe të ndryshme të faqeve të tjera të internetit, për të cilat ju rekomandojmë të i lexoni politikat e privatësisë të faqeve të tyre.

Politikat rishikohen çdo vit ose sa herë që kërkohet nga ndonjë ndryshim ligjor, dhe publikohen në mënyrë transparente në: <https://kline.rks-gov.net>.



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIC OF KOSOVO  
REPUBLIKA KOSOVO

KOMUNA E KLINËS  
MUNICIPALITY OF KLINA  
OPŠTINA KLINA



[www.komuna-kline.org](http://www.komuna-kline.org)

# POLITIKE PRIVATNOSTI U OPŠTINI KLINA

|                                   |  |                  |                              |
|-----------------------------------|--|------------------|------------------------------|
| REPUBLICA E KOSOVËS               |  | REPUBLICA KOSOVA |                              |
| Klina, 18.08.2025                 |  |                  |                              |
| Njësi org.<br>Unit<br>Organ. Jed. |  |                  | Alm.<br>Autorit.<br>in Just. |
| 01-030-26616/25                   |  |                  |                              |

Avgusta, 2025

|                                                                                                |    |
|------------------------------------------------------------------------------------------------|----|
| Definicije i izrazi korišćeni u politici privatnosti .....                                     | 3  |
| Načela obrade ličnih podataka .....                                                            | 4  |
| Izjava predsednika opštine Klinč o izradi politike privatnosti i zaštiti ličnih podataka ..... | 5  |
| Uvod u politiku privatnosti u opštini Klinč .....                                              | 6  |
| Ko obrađuje i odgovoran je za vaše lične podatke .....                                         | 7  |
| Kategorije obrađenih podataka .....                                                            | 9  |
| Svrha upotrebe ličnih podataka .....                                                           | 9  |
| Pravni osnov obrade .....                                                                      | 10 |
| Sa kim delimo prikupljene lične podatke? .....                                                 | 10 |
| Koja su vaša prava? .....                                                                      | 10 |
| Pravo na žalbu .....                                                                           | 11 |
| Bezbednost ličnih podataka .....                                                               | 11 |
| Ažuriranje politike privatnosti .....                                                          | 11 |

## DEFINICIJE I IZRAZI KORIŠĆENI U POLITICI PRIVATNOSTI

Lični podatak – svaka informacija koja se odnosi na fizičko lice koje je identifikovano ili se može identifikovati (“subjekt podataka”); identifikovano fizičko lice je ono koje se može direktno ili indirektno identifikovati, posebno upućivanjem na identifikator kao što su ime, identifikacioni broj, podaci o lokaciji, onlajn identifikator ili jedan ili više faktora specifičnih za fizički, psihološki, genetski, mentalni, ekonomski, kulturni ili društveni identitet tog fizičkog lica.

Privatnost – poštovanje privatnog i porodičnog života, nepovredivost doma i tajnost korespondencije (telefonske i druge komunikacije), u skladu sa važećim zakonodavstvom.

Osetljivi lični podaci – lični podaci koji otkrivaju etničko ili rasno poreklo, politička ili filozofska uverenja, versku pripadnost, članstvo u sindikatu, podatke o zdravstvenom stanju ili seksualnom životu, uključujući evidenciju krivičnih dela i prekršaja u skladu sa zakonom.

Obrada – svaka radnja ili niz radnji koje se vrše nad ličnim podacima automatski ili ne, kao što su: prikupljanje, beleženje, organizovanje, strukturiranje, čuvanje, prilagođavanje ili izmena, pristup, konsultovanje, upotreba, objavljivanje prenosom, distribucija ili učinjenje dostupnim, usklađivanje ili kombinovanje, ograničenje, brisanje ili uništavanje.

Kontrolor podataka – svako fizičko ili pravno lice iz javnog sektora koje samostalno ili zajedno sa drugima određuje svrhu i način obrade ličnih podataka.

Obrađivač podataka – svako fizičko ili pravno lice iz javnog sektora koje obrađuje lične podatke za i u ime kontrolora podataka.

Službenik za zaštitu ličnih podataka – fizičko ili pravno lice iz javnog sektora koje informiše i savetuje kontrolora ili obrađivača i zaposlene koji obavljaju obradu o njihovim obavezama u skladu sa Zakonom o zaštiti ličnih podataka i podzakonskim aktima.

Agencija za informisanje i privatnost (Agencija) – nezavisna agencija odgovorna za nadzor nad sprovođenjem zakonodavstva o pristupu javnim dokumentima i zaštiti ličnih podataka, u cilju zaštite osnovnih prava i sloboda fizičkih lica u vezi sa obradom ličnih podataka, kao i obezbeđivanja pristupa javnim dokumentima.

## NAČELA OBRADE LIČNIH PODATAKA

1. Načelo zakonitosti, pravičnosti i transparentnosti – lični podaci se obrađuju nepristrasno, zakonito i transparentno, ne narušavajući dostojanstvo subjekata podataka.
2. Načelo ograničenja svrhe – lični podaci se prikupljaju samo za jasno određene, zakonite i legitimne svrhe i ne mogu se dalje obrađivati na način koji je u suprotnosti sa tim svrhama.
3. Načelo minimizacije podataka – lični podaci moraju biti primereni, relevantni i ograničeni na ono što je neophodno za svrhu zbog koje se obrađuju.
4. Načelo tačnosti – lični podaci moraju biti tačni i ažurni. Mora se preduzeti svaka razumna mera da se netačni podaci, uzimajući u obzir svrhu obrade, odmah izbrišu ili isprave.

5. Načelo ograničenja čuvanja – lični podaci se mogu čuvati samo onoliko koliko je potrebno za ostvarenje svrhe. Nakon ostvarene svrhe, podaci se brišu, uništavaju, blokiraju ili anonimizuju, osim ako zakon ne predviđa drugačije.
6. Načelo integriteta i poverljivosti – lični podaci se obrađuju na način koji obezbeđuje odgovarajuću sigurnost, uključujući zaštitu od neovlašćene ili nezakonite obrade, kao i od slučajnog gubitka, uništenja ili oštećenja.
7. Načelo odgovornosti – kontrolor mora biti odgovoran i sposoban da dokaže usklađenost sa svim načelima iz Zakona o zaštiti ličnih podataka.

## **IZJAVA PREDSEDNIKA OPŠTINE KLINĚ O IZADI POLITIKE PRIVATNOSTI I ZAŠTITI LIČNIH PODATAKA**

Kao predsednik opštine Klinë, osećam visoku odgovornost i posvećenost da garantujem zaštitu osnovnih prava i sloboda naših građana, uključujući i pravo na privatnost i očuvanje ličnih podataka. U vremenu kada se tehnologija brzo razvija, a digitalizacija javnih usluga širi svakim danom, zaštita ličnih podataka postala je institucionalna, pravna i moralna obaveza koja se mora tretirati sa ozbiljnošću i potpunom transparentnošću.

Opština Klinë se obavezala da izradi i primeni jasne politike privatnosti koje određuju način prikupljanja, korišćenja, čuvanja i deljenja ličnih podataka građana, u skladu sa Zakonom o zaštiti ličnih podataka br. 06/L-082, kao i najboljim međunarodnim standardima i evropskim zakonodavstvom. Ove politike će biti dostupne, razumljive i ažurirane kako bi svaki građanin bio informisan o pravima i garancijama koje ima u vezi sa sopstvenim ličnim informacijama.

Uloga ovih politika je ključna u stvaranju efikasne, pouzdane i odgovorne administracije prema građanima. Zaštita ličnih podataka nije samo pravna obaveza, već i važan element izgradnje poverenja građana u javne institucije. U tom okviru, Opština Klinë će preduzeti sve neophodne mere za obezbeđenje tehničke i organizacione sigurnosti svojih sistema kako bi se sprečila bilo kakva zloupotreba ili neovlašćen pristup ličnim podacima građana.

Takođe, angažovaćemo se na redovnoj obuci opštinskog osoblja o važnosti zaštite privatnosti i praktičnoj primeni relevantnih politika. Saradnja sa Agencijom za informisanje i privatnost, organizacijama civilnog društva i samim građanima biće kontinuirana i otvorena za dalja poboljšanja.

Na kraju, uveravam sve građane da je Opština Klinë posvećena tome da zaštita ličnih podataka bude visoki prioritet u svakom institucionalnom postupku i politici. Privatnost je osnovno pravo, a njeno očuvanje zajednička je odgovornost koju gradimo kroz poverenje, transparentnost i punu posvećenost.

Predsednik Opštine Klinë, Prof. Dr. Zenun Elezaj



## **UVOD U POLITIKU PRIVATNOSTI U OPŠTINI KLINĀ**

Opština KlinĀ, u skladu sa vaŹećim zakonodavstvom o zaštitu liĉnih podataka, odnosno Zakonom o zaštiti liĉnih podataka i relevantnim standardima, izradila je Politiku privatnosti sa ciljem da garantuje osnovna prava i slobode građana, sa posebnim naglaskom na zaštitu liĉnih podataka i privatnosti pojedinca. Ova politika jasno definiše prava, odgovornosti, principe i kaznene mere koje se primenjuju u sluĉaju neovlašćenog rukovanja podacima, obezbeđujući zakonito, praviĉno i transparentno postupanje sa njihovim liĉnim podacima.

Cilj ove politike jeste da se obezbedi efikasna zaštita liĉnih podataka pojedinaca, da se jasno definišu prava i odgovornosti ukljuĉenih strana, da se uspostave smernice za obradu podataka i da se predvide kaznene mere u sluĉaju kršenja ili neovlašćene upotrebe. Ova politika ima za cilj i podizanje institucionalne i građanske svesti o vaŹnosti privatnosti i zaštite liĉnih informacija.

Opseg politike obuhvata sve sektore i sluŹbe unutar Opštine KlinĀ koje obrađuju liĉne podatke, ukljuĉujući zaposlene, saradnike, građane, pruŹaoce javnih usluga i svaku drugu stranu koja ima pristup ili interakciju sa liĉnim podacima u okviru institucionalnog rada. Politike se primenjuju na sve oblike podataka, bilo u fiziĉkom ili digitalnom formatu.

Prema zakonskoj definiciji, „liĉni podatak“ podrazumeva svaku informaciju koja se odnosi na identifikovano ili identifikabilno fiziĉko lice, koje se moŹe identifikovati direktno ili indirektno putem imena, identifikacionog broja, lokacije, onlajn identifikatora ili drugih specifiĉnih karakteristika fiziĉkog, psihološkog, genetskog, mentalnog, ekonomskog, kulturnog ili društvenog identiteta.

Kroz ovu politiku, Opština KlinĀ se obavezuje da obezbedi zakonitu, praviĉnu i transparentnu obradu liĉnih podataka građana i svojih zaposlenih, postavljajući jasne standarde za oĉuvanje poverljivosti i bezbednosti. Istovremeno, politika definiše institucionalne obaveze za nadzor nad sprovođenjem zakona i za obezbeđivanje praviĉnog pristupa javnim dokumentima, bez ugroŹavanja privatnosti pojedinca.

Primena ove politike u Opštini KlinĀ predstavlja znaĉajan korak ka jaĉanju institucionalne transparentnosti, povećanju javne odgovornosti i izgradnji sigurnog i pouzdanog okruŹenja za građane. Ova politika zaštite liĉnih podataka primenjuje se ukoliko ste kandidat za posao, ugovorna strana, uĉestvujete na obuci koju organizujemo, posetite <https://kline.rks-gov.net/>, koristite neku uslugu, podnesete zahtev putem mejla: [komuna.kline@rks-gov.net](mailto:komuna.kline@rks-gov.net) ili preko naše internet stranice.

## **KO OBRAĐUJE I ODGOVORAN JE ZA VAŠE LIĀNE PODATKE?**

Obrađivaĉ liĉnih podataka je svako fiziĉko ili pravno lice iz javnog sektora koje obrađuje liĉne podatke za i u ime kontrolora podataka.

Obrađivaĉ liĉnih podataka u Opštini KlinĀ je, sa adresom u okviru Direkcije za administraciju.



1.2. Pruža savete, po potrebi, u vezi sa procenom uticaja na zaštitu podataka i prati njeno sprovođenje;

1.3. Sarađuje sa Agencijom za informisanje i privatnost;

1.4. Deluje kao kontakt tačka za Agenciju u vezi sa pitanjima obrade, uključujući i prethodno savetovanje iz člana 36 ovog zakona i po potrebi se konsultuje u vezi sa svim drugim pitanjima.

2. Službenik za zaštitu podataka, pri obavljanju svojih dužnosti, uzima u obzir rizik povezan sa aktivnostima obrade, uzimajući u obzir prirodu, predmet, kontekst i svrhe obrade.

Službenik za zaštitu ličnih podataka nalazi se u okviru Direkcije za administraciju, imenovan odlukom predsednika Opštine Klinë, a njegovi podaci su objavljeni na zvaničnom sajtu: <https://kline.rks-gov.net/>.

**KONTROLOR:** Opština Klinë

**OBRAĐIVAČI:** Opštinske direkcije, institucije u nadležnosti Opštine, treće ugovorne strane sa posebnim ovlašćenjem

**SLUŽBENIK ZA ZAŠTITU LIČNIH PODATAKA:** Imenovan odlukom predsednika Opštine, u okviru Direkcije za administraciju.

## **KATEGORIJE OBRAĐENIH PODATAKA**

U zavisnosti od specifičnih ciljeva i razloga, Opština Klinë obrađuje sve ili neke od sledećih ličnih podataka, pojedinačno ili u kombinaciji:

Podaci za identifikaciju: ime, prezime, podaci iz lične karte ili pasoša,

Kontakt podaci: adresa, e-mail, broj telefona,

Podaci o obrazovanju, zdravlju, stručnim kvalifikacijama i radnom angažmanu,

Drugi podaci traženi prema posebnim zakonima koji regulišu radne ili ugovorne odnose,

Ostale informacije i lični podaci neophodni za ispunjavanje zakonskih obaveza Opštine Klinë u cilju obezbeđivanja sigurnosti u pružanju usluga vazdušnog navigacionog sistema,

Fotografije i video zapisi sa konferencija ili događaja.

## **ZA KOJE SVRHE KORISTIMO VAŠE LIČNE PODATKE?**

– Ispunjavanje zakonskih obaveza predviđenih Zakonom br. 06/L-082 o zaštiti ličnih podataka, i važećim međunarodnim standardima Evropske unije za zaštitu podataka,

1. Ako se obrada vrši u ime kontrolora, isti angažuje samo obrađivače koji pružaju dovoljne garancije za sprovođenje odgovarajućih tehničkih i organizacionih mera kako bi obrada bila u skladu sa ovim zakonom i obezbedila zaštitu prava subjekata podataka.
2. Obradivač ne angažuje drugog obrađivača bez prethodnog posebnog ili opšteg pismenog odobrenja kontrolora. U slučaju opšteg pismenog odobrenja, obrađivač obaveštava kontrolora o svim planiranim promenama u vezi sa dodavanjem ili zamenom drugih obrađivača, dajući mu mogućnost da se usprotivi tim promenama.
3. Obrada od strane obrađivača uređuje se ugovorom koji je obavezujući za obrađivača u odnosu na kontrolora i koji određuje predmet i trajanje obrade, prirodu i svrhu obrade, vrstu ličnih podataka i kategorije subjekata podataka, kao i obaveze i prava kontrolora. Taj ugovor posebno predviđa da obrađivač:

3.1. Obraduje lične podatke samo u skladu sa dokumentovanim uputstvima kontrolora, uključujući i u vezi sa prenosom ličnih podataka u treće zemlje ili međunarodne organizacije, osim ako se to zahteva zakonom kojem je obrađivač podložan; u tom slučaju, obrađivač obaveštava kontrolora o tom pravnom zahtevu pre obrade, osim ako zakon zabranjuje takvo obaveštavanje iz važnih razloga javnog interesa. Obradivač odmah obaveštava kontrolora ako smatra da je neko uputstvo u suprotnosti sa zakonom;

3.2. Garantuje da su osobe ovlašćene za obradu ličnih podataka obavezane poverljivošću ili su pod odgovarajućom zakonskom obavezom poverljivosti;

3.3. Preduzima sve mere zahtevane prema članu 31 Zakona o zaštiti podataka;

3.4. Poštuje uslove navedene u stavovima 2. i 4. ovog člana u vezi sa angažovanjem drugog obrađivača;

3.5. Uzimajući u obzir prirodu obrade, pomaže kontroloru odgovarajućim tehničkim i organizacionim merama, u meri u kojoj je to moguće, u ispunjavanju obaveze kontrolora da odgovori na zahteve za ostvarivanje prava subjekata podataka;

3.6. Pomaže kontroloru u obezbeđivanju usklađenosti sa obavezama u skladu sa zakonom, itd.

Kontrolor podataka – svako fizičko ili pravno lice iz javnog sektora koje samostalno ili zajedno sa drugima određuje svrhe i načine obrade ličnih podataka.

Odgovornost kontrolora:

1. Uzimajući u obzir prirodu, predmet, kontekst i svrhe obrade, kao i rizike koji mogu uticati na prava i slobode fizičkih lica, kontrolor primenjuje odgovarajuće tehničke i organizacione mere kako bi osigurao i bio sposoban da dokaže da se obrada vrši u skladu sa ovim zakonom. Ove mere se pregledaju i ažuriraju po potrebi.
2. Ako je proporcionalno aktivnostima obrade, mere iz stava 1 Zakona o zaštiti ličnih podataka uključuju sprovođenje odgovarajućih politika zaštite podataka od strane kontrolora.

Službenik za zaštitu ličnih podataka ima najmanje sledeće dužnosti:

1.1. Informiše i savetuje kontrolora ili obrađivača i zaposlene koji sprovode obradu o njihovim obavezama u skladu sa ovim zakonom i podzakonskim aktima;

- Postupanje po nalogima nadležnih državnih organa,
- Pružanje javnih usluga,
- Selekcija zaposlenih, uključujući sprovođenje stručnih i jezičkih obuka za nove regrute,
- Zaključivanje ugovora i predugovornih odnosa,
- Obezbeđivanje sigurnosti zaposlenih, posetilaca i infrastrukture preduzeća, putem video nadzora, fizičkog obezbeđenja, kontrole pristupa i registracije eksternih posetilaca,
- Obezbeđivanje nesmetanog rada, održavanja i sigurnosti internet stranice i informaciono-komunikacionih sistema Opštine Klinč,
- Organizovanje i sprovođenje stručnih obuka od strane organizacija za obuku u okviru Opštine Klinč,
- Obrada zahteva u skladu sa Zakonom br. 06/L-081 o pristupu javnim dokumentima,
- Promocija aktivnosti opštine u vezi sa zaštitom ličnih podataka, uključujući distribuciju promotivnog materijala, postavljanje fotografija/video zapisa na web stranicu, Facebook, Instagram, Twitter, LinkedIn ili druge medije.

## **PRAVNI OSNOV OBRADE**

Opština obrađuje lične podatke subjekata u skladu sa Zakonom br. 06/L-082 o zaštiti ličnih podataka, i u skladu sa evropskim zakonodavstvom o zaštiti podataka.

U određenim slučajevima, podatke obrađujemo samo uz prethodnu saglasnost subjekta podataka. Data saglasnost može se opozvati u bilo kom trenutku.

## **SA KIM DELIMO PRIKUPLJENE LIČNE PODATKE?**

Nadležnim organima kao što su bezbednosni, sudski i nadzorni organi, koji na osnovu pravnog akta imaju ovlašćenje da zatraže lične podatke od Opštine Klinč za određene subjekte.

## **KOJA SU VAŠA PRAVA?**

Kada se vaši lični podaci obrađuju od strane Opštine Klinč, imate pravo da:

- Pristupite svojim podacima i da u svakom trenutku zahtevate njihovu ispravku ili ažuriranje ako su netačni ili nepotpuni,

- Zahtevate brisanje ('pravo na zaborav') vaših podataka i obustavu obrade pod određenim okolnostima,
- Zahtevate da se gorepomenute izmene saopšte i trećim stranama kojima su podaci otkriveni,
- Podnesete žalbu ako verujete da su vaša prava na zaštitu podataka prekršena.

## **PRAVO NA ŽALBU**

U skladu sa Zakonom br. 06/L-082 o zaštiti ličnih podataka, svako fizičko lice koje smatra da mu je povređeno pravo na zaštitu ličnih podataka može podneti žalbu Agenciji za informisanje i privatnost na adresu: Rr. Zejnel Salihu - br.22, 10000, Priština, Republika Kosovo, ili putem email adrese: [info@aip-rks.org](mailto:info@aip-rks.org).

## **BEZBEDNOST LIČNIH PODATAKA**

Opština Klinë primenjuje odgovarajuće fizičke, organizacione i tehničke mere za zaštitu vaših ličnih podataka u skladu sa odredbama Zakona br. 06/L-082 o zaštiti ličnih podataka.

Trajanje čuvanja ličnih podataka zavisi od svrhe obrade za koju su podaci prikupljeni i regulisano je relevantnim Zakonom o državnim arhivama ili drugim važećim zakonom.

## **AŽURIRANJE POLITIKE PRIVATNOSTI**

S vremena na vreme možemo ažurirati našu politiku privatnosti i obavestićemo vas o svakoj izmeni postavljanjem nove verzije Politike privatnosti na zvaničnu web stranicu Opštine Klinë.

Internet stranica može sadržati linkove ka drugim sajtovima, te preporučujemo da pročitate njihove politike privatnosti.

Politike se revidiraju jednom godišnje ili svaki put kada to zahteva neka zakonska promena, i objavljuju se transparentno na: <https://kline.rks-gov.net>.